2. Analizë e gjendjes ekonomike të grave në media dhe dallimi në paga si formë e diskriminimit gjinor	33
3. Efekti i “tavanit të qelqtë” apo barrierat e padukshme për avancim të femrave në profesion.....	36
4. Analizë e strukturës gjinore në media dhe arsyet për nivelin e ulët të përfaqësimit të femrave në pozita menaxheriale	40
Konkluzat.....	44
Rekomandim.....	45
Bibliografia.....	46

Barazia gjinore pa dyshim se është një faktor tejet i rëndësishëm për zhvillimin e një shoqërie. I përmirëson produktivitetin dhe rritjen ekonomike, ndikon pozitivisht në mirëqenien e grupeve të ndryshme sociale dhe në këtë mënyrë kontribuon për zhvillimin e shoqërisë dhe gjeneratave të ardhshme, por edhe për efikasitetin e institucioneve. Sigurimi i barazisë gjinore në sferën mediatike ndërkohë është një parakusht për një hapësirë prosperuese mediatike në një shoqëri demokratike. Përfaqësimi i barabartë i grave nëpër redaksi por edhe në përmbajtjet mediatike ndikon para se gjithash për sigurimin e të drejtave dhe lirisë së shprehjes së grave dhe mundësive të barabarta në tregun e punës, por edhe për promovimin e të drejtave gjinore në një shoqëri, sidomos duke marrë parasysh rolin e mediave si instrument për ndryshime në aspekt të barazisë gjinore, para se gjithash për shkak të fuqisë transformuese në formimin e perceptimit për gjininë në shoqëri.

Edhe pse në vitet e fundit është vërejtur një përparim në shtet në aspekt të zbatimit të politikave për barazi gjinore, megjithatë, në praktikë ende ekziston problem me mungesën e përfaqësimit të grave në poste drejtuese por edhe në vendimmarrje në të gjitha sferat e shoqërisë. Konkretisht tek mediat sipas të dhënave të fundit zyrtare, gratë dominojnë nëpër redaksi, ndërsa në poste redaktuese e në veçanti në poste menaxheriale ende dominojnë meshkujt.

Qëllimi i këtij hulumtimi është që t'i analizojë gjendjet dhe arsyet për pabarazinë gjinore në media dhe barrierat për avancim që ndikojnë në përfaqësimin e pabarabartë të grave në poste udhëheqëse në media, si dhe të ofrohen zgjidhje për tejkalimin e tyre. Janë marrë parasysh gjendja ekonomike e gazetareve dhe dallimi në pagat, format e diskriminimit gjinor në organizata, mundësitë për trajnime dhe edukim shtesë por edhe avancim në karrierë.

Për këtë qëllim ishin analizuar hulumtimet e deritanishme, studimet, dokumentet për politika, kumtesat e analizat, por edhe korniza ligjore aktuale dhe informacionet e publikuara nga institucionet dhe organizatat relevante, ndërsa në periudhën nga tetori deri në nëntor të vitit 2021 ishin realizuar edhe disa anketa gjysmë të strukturuar me 20 të anketuar, gazetarë (përfaqësuese tipike të grupit të targetuar që ishin selektuar në bazë të principit për variacione maksimale, heterogjene sipas moshës, etnitetit, vendit të jetës dhe llojit të medias ku punojnë), me qëllim që të identifikohen barrierat për avancim në profesion. Të dhënat kualitative nga intervistat e realizuara janë analizuar në mënyrë narrative dhe janë prezantuar në formë citatesh.

Në dekadat e fundit, Maqedonia e Veriut ka vendosur një kornizë të fuqishme ligjore dhe politika me qëllim përforcimin e barazisë gjinore në shtet. Qeveria e Maqedonisë së Veriut nëpërmjet mekanizmave të saj gjatë periudhës së fundit ka arritur disa rezultate të rëndësishme në aspekt të realizimit të barazisë gjinore. Janë sjellë: *Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi*,¹ i cili është i harmonizuar me standardet ndërkombëtare me të cilat është i rregulluar parandalimi dhe ndalesa për diskriminim, format dhe llojet e diskriminimit, procedurat për mbrojtje nga diskriminimi dhe *Ligji për parandalim dhe mbrojtje të grave nga dhuna dhe dhuna në familje*,² që është tërësisht në pajtueshmëri me Konventën e Stambollit. Ministria e Punës dhe Politikës Sociale ka nisur proces për përgatitjen e një strategjie të re për barazi gjinore 2021-2026 e cila parashikon vendosjen e një kornize për rritjen e pjesëmarrjes së grave në strukturat vendimmarrëse në media, në pozita redaktuese dhe drejtorie por edhe për edukim dhe ngritje të vetëdijes për çështjet gjinore tek të gjithë punonjësit mediatik.

Gjatë periudhës së ardhshme është paralajmëruar edhe përgatitja e Ligjit të ri për barazi gjinore me të cilin pritet që të përmirësohen mekanizmat për barazi gjinore në nivel kombëtar dhe lokal, si dhe për formimin e Qendrës për trajnim për buxhetim konform barazisë gjinore, që do të jetë një arsimim i vazhdueshëm për gjithë makinerinë gjinore në shtet.³

Ligji për shërbime mediatike audio dhe audio-vizuale (2018) parashikon përfaqësim të barabartë të grave në trupat për sjellje të vendimeve mediatike dhe ndalon krijimin dhe emetimin e programeve me përmbajtje diskriminuese, mes tjerash në bazë gjinore dhe orientimi seksual. Sipas nenit 17 nga *Ligji për mundësi të njëjta mes burrave dhe grave*,⁴ mediat janë të obliguara që të kontribuojnë për ngritjen e vetëdijes për barazinë gjinore si dhe për pjesëmarrje të barabartë të burrave dhe grave në krijimin e koncepteve dhe përmbajtjeve programore. Ky nen e rregullon edhe rolin e mbikëqyrjes dhe kontrollit në kuadër të së cilës ASHMAA përgatitë analiza vjetore për përfaqësimin e grave dhe burrave në konceptet programore dhe përmbajtjet e mediave.

Me ligjin për mundësi të barabarta, në kapitullin 6 definohej mundësitë për “mbrojtje juridike” të të drejtës për trajtim të njëjtë të burrave dhe grave, që përfshin edhe procedurë ankese si dhe referenca që çojnë në parashitjet para Avokatit të Popullit, Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi dhe gjykata kompetente (neni 20).

1 "Gazeta Zyrtare e RMV-së", nr. 258 nga data 30.10.2020

2 "Gazeta Zyrtare e RMV-së", nr. 24 nga data 29.01.2021

3 MPPS, Shahpanska – Avancimi i barazisë gjinore është obligimi jonë për të cilin vazhdojmë të punojmë me përkushtim. Qasur më 30 tetor 2021, <https://vlada.mk/node/24645>

4 Gazeta Zyrtare e RMV-së", nr.166/2014

Ligji për mundësi të barabarta në mënyrë shtesë do të vërtetojë se Ministria për punë dhe politikë sociale do të bëjë mbikëqyrje të zbatimit të ligjit, ndërsa inspektimit do ta bëjë Inspektorati shtetëror i punës.

Si vend kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian, Maqedonia e Veriut ka ndër marrë dhe vazhdon të ndër merr hapa në drejtim të harmonizimit të legjislativit të saj me BE-në. Në nivel të Bashkimit Evropian, ekzistojnë dy direktiva që paraqesin angazhimin e vendeve të BE-së për sigurimin e mbrojtjes së barazisë mes meshkujve dhe femrave. Këto janë direktivat e Këshillit 2004/113/KE për parimin e trajtimit të barabartë mes meshkujve dhe femrave për qasjen dhe furnizimin me të mira dhe shërbime, dhe Direktiva 2006/54/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit për zbatimin e trajtimit të njëjtë të burrave dhe grave rreth çështjeve të punësimit dhe profesionit. Që të dy direktivat gjinore të BE-së përmbajnë definicione për diskriminim (direkt apo indirekt), përfshirë këtu edhe shqetësimin seksual, dhe parashikojnë barazi në trajtimin e fushave të lartpërmendura (të mira dhe shërbime, punësim), njëkohësisht duke u fokusuar edhe në mjetet juridike dhe zbatimi.

Shembuj për praktika të mira



Irlanda

Neni 23 i Ligjit për media nr.38/2011 parashikon: të gjithë organizatat mediatike të dorëzojnë raporte vjetore deri te Komisioni për media: raportet vjetore të përmbajnë informacione të ndryshme që përfshijnë edhe të dhëna për përfaqësimin e të dy gjinive në program dhe intervista, si dhe përfaqësimi i grave dhe burrave si punonjës mediatik në vetë organizatat.

Britania e Madhe

Sipas ligjit për mundësi të barabarta nga viti 2017, të gjithë kompanitë (përfshirë edhe organizatat mediatike) me numër të caktuar punëtorësh obligohen që ti publikojnë të dhënat për dallimet në paga në bazë gjinore. Kjo rregullativë ka hyrë në fuqi më 6 prill të vitit 2017. Kjo rregullore ndikoi për më shumë aksion të organizatave të mëdha mediatike pasi që kishin mbikëqyrje dhe presion. Pas publikimit të të dhënave për dallimin e pagave në bazë gjinore, pas reagimit të një korrespondenteje të lartë dhe aksionit të Lidhjes Kombëtare të Gazetarëve, BBC ndër mori masa për zbutjen e dallimit të pagave në bazë gjinore. Procesi vazhdon ende, por tashmë është arritur një zbutje e dallimit në paga sipas gjinisë duke shtuar numrin e femrave në pozicione të larta.

Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punonjësve Mediatik (SPGM) dhe Agjencia Mediatike Informativë (MIA) gjatë vitit të kaluar kanë nënshkruar një marrëveshje kolektive që është e para marrëveshje kolektive në SPGM me ndonjë medium në Maqedoninë e Veriut.

ANALIZË E GJENDJES EKONOMIKE TË GRAVE NË MEDIA DHE DALLIMI NË PAGA SI FORMË E DISKRIMINIMIT GJINOR

Sipas Raportit të fundit të “Reporterëve pa kufij” për vitin 2021, Maqedonia e Veriut gjendet në vendin e 90-të në botë sipas lirisë së mediave. Ky është një përparim për dy vende në krahasim me vitin e kaluar dhe rangimi më i lartë nga viti 2013 deri tani.⁵

Megjithatë, Raporti i njëjtë thekson edhe një sërë sfidash që duhet të tejkalohen me qëllim që të përmirësohet kualiteti i gazetarisë. Pagesat e ulëta si dhe mosrespektimi në tërësi i Ligjit për marrëdhëniet e punës nga ana e punëdhënësve, janë problemet më të shpeshta me të cilat ballafaqohet sektori mediatik për vite me radhë.⁶

Gjendja me pandeminë ndërkohë në mënyrë të konsiderueshme e ka përkeqësuar gjendjen në industrinë mediatike në shtet. Anketa që SPGM e ka bërë me 150 të punësuar në industrinë mediatike tregon se frika tek punonjësit mediatik më së shpeshti lidhet me segmentin ekonomik. 30 për qind e të anketuarve kanë thënë se njohin dikë që e ka humbur punën gjatë pandemisë së virusit Korona. 17 për qind e punonjësve mediatik kanë deklaruar se u është ulur paga.⁷

Nuk ekzistojnë të dhëna të sakta për lartësinë e pagave të gazetarëve, as edhe për marrëveshjet për punë, kjo pasi që Enti për Statistikë nuk e ndan këtë profesion si të veçantë. Të dhënat e fundit për lartësinë e pagave të gazetarëve i kemi fituar nga anketa e SPGM-së e realizuar në vitin 2020 e cila nxori në pah se shumica e gazetarëve dhe punonjësve mediatik marrin prej 15 mijë deri 20 mijë denarë,⁸ që është shumë larg nën mesataren në shtet, për periudhën kur është realizuar anketa.⁹

Dallimi në pagat që i marrin gratë dhe burrat paraqet një formë diskriminimi gjinor në vendin e punës. Dallimi nuk ka vetëm rëndësi ekonomike, por paraqet edhe reflektim të marrëdhënieve më të gjëra socio-ekonomike në kuadër të një shoqërie, pra e tregon qasjen e grave deri tek mundësitë ekonomike. (Blunch, 2012).

Pabarazia gjinore dhe dallimi gjinor në paga po qëndron edhe përkundër avancimit të madh të grave në aspekt arsimor, përvojës së punës dhe profesionalizmit në tregun e punës.

5 <https://rsf.org/en/ranking/2021>

6 Probleme prioritare me respektimin e të drejtave të njeriut në Maqedoninë e Veriut, 2020. <https://balkon3.com/mk/wp-content/uploads/2021/01/PRIORITETNI-PROBLEMI-SO-POCHITUVANJETO-NA-CHOVEKOVITE-PRA-VA-VO-RSM.pdf>

7 SPGM: Gazetarët dhe punonjësit mediatik po druajnë nga virusi, por edhe nga humbja e punës. Shkup, 2020. (qasur më 01.11.2021) <https://ssnm.org.mk/komentari/новинарите-и-медиумските-работници-с>


8 SPGM: Gazetarët dhe punonjësit mediatik me paga larg mesatares. Shkup, 2020 (qasur më 01.11.2021) <https://ssnm.org.mk/komentari/новинарите-и-медиумските-работници-с-2>

9 Sipas Entit shtetëror për statistikë për muajin prill të vitit 2020, pagesa mesatare ka qenë 25 830 denarë.

Konkluzat nga dokumenti për politika publike në Rrjetin për Mbrojtje nga Diskriminimi¹⁰ theksojnë se në Maqedoninë e Veriut ende ekziston dallim mes pagave dhe se përqindja e dallimit në paga është madje më e lartë se dallimi i pagave brenda Bashkimit Evropian, që është 14.1 përqind në vitet e fundit.¹¹

Këto të dhëna i konfirmojnë edhe rezultatet nga “Studimi për gratë në Maqedoninë e Veriut 2020/2021”¹² i realizuar nga Fondacioni “Friedrich Ebert” – Shkup sipas të cilëve thuajse dy të tretat e të anketuarave, grave të punësuar ju ka ndodhur që të përfitojnë më pak se burrat duke qenë në të njëjtën pozitë pune apo për të njëjtën punë të përfunduar (60.2 përqind), dhe njëkohësisht, të jenë të trajtuara si jokompetente pasi që janë gra (60.4 përqind).¹³

Se në industrinë mediatike dallimi në paga nuk është një fenomen i theksuar, tregojnë të dhënat e nxjerra në kuadër të një hulumtimi thelbësor për të drejtat e gazetarëve dhe punonjësve mediatik në Maqedoninë e Veriut, i realizuar nga Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punonjësve Mediatik (SPGM) dhe Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë së Veriut (SHGM) në periudhën gusht-shtator të vitit 2021. Në pyetjen: “Në median ku punoni a kanë paga të njëjta burrat dhe gratë për të njëjtin pozicion pune?”, një përqindje e lartë prej 44.2 përqind kanë dhënë përgjigjen “po”, ndërsa vetëm 9 përqind kanë thënë “jo”. Një përqindje e lartë prej 39.4 përqind kanë thënë se nuk e dinë, pasi që me gjasë nuk kanë informacione për lartësinë e pagave të kolegëve dhe eprorëve të tyre, prandaj edhe nuk ka mundësi për gjykim dhe konkluzë reale të gjendjes.



10 Si të zvogëlohet dallimi gjinor në paga në Maqedoninë e Veriut: Shkup, 2020, qasur më 1 nëntor 2021 <http://coalition.org.mk/wp-content/uploads/2020/09/Dokument-za-javni-politiki-Ednakvi-plati-MKD.pdf>

11 https://ec.europa.eu/info/sites/default/files/aid_development_cooperation_fundamental_rights_equalpayday_factsheet.pdf

12 <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/skopje/17556-20210318.pdf>

13 “Studim për gratë në Republikën e Maqedonisë së Veriut”, FES Shkup, 2021

14 Hulumtim për të drejtat e gazetarëve dhe punonjësve mediatik në Maqedoninë e Veriut e realizuar nga Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punonjësve Mediatik (SPGM) dhe Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë së Veriut (SHGM) në periudhën gusht – shtator 2021.

Konkluzat e njëjtë mund të nxirret edhe nga deklaratat e gazetarëve të intervistuar për qëllimet e këtij hulumtimi. Një pjesë e madhe prej tyre theksojnë se problemi është me pagat e ulëta tek gazetarët në përgjithësi, e jo dallimi gjinor në paga pasi vlerësojnë se nuk është i përhapur shumë në sferën e tyre, apo nuk kanë informacion për këtë çështje.



“Absolutisht nuk ekziston dallim në paga të punonjësve mediatik në bazë të gjinisë. Kryesisht, pagat e gazetarëve në shtet janë tejet të ulëta nëse merret parasysh: puna në terren, rreziku, puna për fundjave dhe festa, puna jashtë orarit, por në vendin tim të punës por edhe nga bisedat me kolegët, nuk kam parë tendencë që një femër gazetare të merr më pak pagë mujore vetëm sepse është femër. Megjithatë ajo që shqetëson është se të dyja bashkë, edhe femrat edhe meshkujt gazetarë kanë shumë të ardhura të ulëta, sidomos nëse bëhet krahasim me pagat e redaktorëve”.

“Në pozicion të njëjtë edhe gratë edhe burrat paguhen njësoj, por megjithatë mbetet fakti se burrat avancojnë më shpejtë dhe më lehtë”.

“Nuk e di se sa fitojnë kolegët meshkuj. Por kryesisht mendoj se punonjësve meshkuj shumë më lehtë ua pranojnë kërkesën për rritje page, nëse ka, se sa femrave”.

“Sinqerisht nuk mendoj se situata jo shumë e mirë lidhur me pagat në sektorin mediatik ka lidhje me gjininë. Më shumë ka lidhje me dallimin me pagave të gazetarëve dhe redaktorëve dhe me atë se puna dhe munda të gazetarëve nuk vlerësohet”.

Përsëri theksohet problemi me pagat e ulëta të gazetarëve dhe gazetarëve, por edhe dallimi i madh në pagat e gazetarëve dhe redaktorëve e menaxherëve. Por, një e dhënë interesante është se këto probleme femrat e anketuara i lidhin me përfaqësimin më të madh të grave në këtë sferë dhe faktin se gazetaria llogaritet si “profesion femrash”.

“Pasi që punoj në media private – pagat e kolegëve të mi nuk i kam të njohura, por nuk besoj se kolegët e mi meshkuj përfitojnë më shumë duke qenë në pozicionin e njëjtë të punës. Ndërsa në përgjithësi vlerësoj se gratë fitojnë më pak në gazetari pasi që gazetaria gjatë viteve të fundit u bë më shumë femërore dhe kështu edhe pagat filluan të bëhen më të vogla se sa në sektore të tjera. Tani vetëm pozicionet udhëheqëse në gazetari (kryeredaktor, drejtor) paguhen më mirë, ndërsa pozicionet si gazetar, reporter janë në një nivel më të ulët”.

“Është fakt se ka një numër më të madh të gazetarëve femra se sa gazetarëve meshkuj, por a po stagnojnë pagat në këtë sektor vetëm për këtë shkak?”

“Në bazë të hulumtimeve që i kam bërë personalisht gjatë viteve të fundit për këtë temë, gazetaria është profesion “femrash”. Kjo ndoshta do ti qartësojë faktet se gazetaret dhe redaktorët femra janë shumicë në gazetari, për dallim prej drejtoreshave të cilat janë në numër më të vogël në krahasim me drejtorët të cilët janë më të paguarit dhe

janë në kulmin e piramidës së punonjësve mediatik, nëse mund të llogariten si pjesë e kësaj kategorie. Ende ballafaqohemi me paragjykime se femrat janë kryesisht për paga mesatare dhe paralelisht përgjegjëse për shtëpinë, fëmijët, kujdesin e familjes, ndërsa burrat janë ata që krijojnë politika dhe janë të paguar më mirë për kontributin e tyre”.

Problemi me të ardhurat e ulëta si një aspekt shqetësues nga aspekti gjinor, por edhe nga aspekti i profesionalizmit, theksohet edhe në Analizën e strukturës gjinore tek pagat në radiodifuzion, që është zbatuar nga Agjencia për Shërbimet Mediatike Audio dhe Audio-vizuale, në të cilën theksohet se një pjesë e madhe e gazetareve në mediat private, në të gjitha nivelet, kanë të ardhura shumë të ulëta, të cilat nuk u ofrojnë stabilitet financiar dhe ndikojnë në rezistencën e tyre nga presionet e qendrave të ndryshme të fuqisë.¹⁵

3

EFEKTI I “TAVANIT TË QELQTË” APO BARRIERAT E PADUKSHME PËR AVANCIM TË FEMRAVE NË PROFESION

Me kryqëzimin e rezultateve të anketës me gazetarët dhe punonjësit mediatik, variacionet në indikatorët theksojnë se perceptimi për respektimin e barazisë gjinore ka tendencë që të barazohet me lartësinë e të ardhurave mes meshkujve dhe femrave, ndërsa shumë më pak me treguesit e tjerë për barazinë gjinore.¹⁶

Se vetë femrat nuk e njohin diskriminimin në bazë të gjinisë dhe pozitën jo të volitshme në aspekt të vendim të punës në raport me meshkujt, dëshmohet edhe me: “Studimin për gratë në RMV 2020/2021”, si dhe me më shumë hulumtime të tjera të viteve të fundit (OSVE, 2013, “Perceptimet për barazinë gjinore: gratë dhe ekonomia maqedonase, 2011).

Prandaj ishte e domosdoshme që të hulumtohet prania e të ashtuquajturës “tavan prej qelqi”, ose “barriera e padukshme në hierarki që i ndalon femrat dhe pakicat që të fitojnë pozicione në nivele më të larta” (Merriam-Webster, 2019), apo “barrierë e padukshme por reale nëpërmjet të cilës mund të shihet niveli i ardhshëm i avancimit, por nuk mund të arrihet nga ana e të punësuarve të kualifikuar dhe meritort”.

Gazetaret femra vërtetuan se fenomeni “tavan prej qelqi” ekziston, i reflektuar në forma të ndryshme të diskriminimit në kuadër të vetë organizatës, por ekziston edhe

¹⁵ Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audio-vizuale: Analizë e strukturës gjinore të pagave në radiodifuzion për vitin 2020. Qasur më 20 tetor 2021. <https://avmu.mk/wp-content/uploads/2020/11/Rod-i-plati-vo-radiodifuzija-MK-web-1.pdf>

¹⁶ Hulumtim për të drejtat e gazetarëve dhe punonjësve mediatik në Maqedoninë e Veriut e realizuar nga Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe punonjësve Mediatik(SPGM) dhe Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM), në periudhën gusht-shtator 2021.

diskriminimi gjinor nga ana e opinionit të gjerë në të cilin janë të ekspozuar për shkak të natyrës specifike të punës që e kanë. Në raste kur femrat raportojnë për tema të ndjeshme, ata ballafaqohen me ofendime dhe nënçmime të cilat e rrënojnë imazhin e tyre profesional dhe privat, dhe përjetojnë kualifikime që u drejtohen vetëm femrave në mënyrë pezhorative, e që janë të bazuara në paragjykime dhe stereotipe gjinore. Kjo dukuri në mënyrë indirekte reflektohet edhe në ardhmërinë e tyre profesionale dhe jetën e tyre private.



“Personalisht nuk kam qenë e ekspozuar në diskriminim direkt në vendin e punës vetëm sepse jam femër. Por, di raste kur kandidatet e cila ka aplikuar për punë nuk u pranua pasi që gjoja do të martohej dhe to merrte pushim të paguar dhe shumë shpejt do të shkonte edhe në pushim të lindjes. Sikur karakteristikat e tjera profesionale nuk kishin rëndësi”.

“Më kanë parashtruar pyetje të pahijshme gjatë intervistës për punë për atë se çfarë planesh kam lidhur me amësinë dhe ngjashëm. Shpesh mi kanë kontestuar kualitetet e mija profesionale bashkëpunëtorë të jashtëm, jam etiketuar në bazë të paragjykimeve lidhur me gjendjen time martesore dhe ngjashëm”.

“Problemi i femrave në këtë profesion është shqetësimi seksual për të cilin flitet shumë pak, ose aspak”.

“Mua më ka ndodhur që të më sulmojnë bashkë me kameramanin gjatë disa protestave, pas një vrasjeje në një lagje të Shkupit. Unë isha duke raportuar drejtpërdrejt derisa na i thyen edhe pajisjet, mua më kapën për flokësh dhe më ofenduan me fjalët “patë”, “shko në shtëpi të bësh gjellën, mos u përziej këtu” etj. Do të thotë diskriminimi dhe fjalët ofenduese seksiste shumicën e kohës vijnë nga jashtë, edhe pse vlerësoj se ka kolege që kanë qenë viktima të shqetësimit seksual edhe brenda, nga eprorët”

“Asnjëherë nuk jam ndjerë e diskriminuar në vendin e punës. Jam ndjerë e diskriminuar në raste kur e kam publikuar ndonjë storje dhe në rrjetet sociale mi kanë drejtuar disa komente diskriminuese, seksiste: se jam e dashura e dikujt, se nuk kam fëmijë, se nuk jam e martuar dhe sulme të tilla të ngjashme të cilat vërtetë ndikojnë, jo vetëm tek femrat gazetarë por edhe tek familjet dhe të afërmit e tyre”.

Efekti i “tavanit të qelqtë” më së shpeshti manifestohet kur bëhet fjalë për ndarje të detyrave dhe përgjegjësi, të cilat përmjet kriterëve “të pashkruara”, ju japin përparësi meshkujve kur ka rrezik, por edhe kur nuk ka rrezik në terren gjatë emërimit të gazetarëve për detyra të caktuara meshkujt llogariten si “gjinia më e fortë”.


“Në fillim të karrierës kolegu im me të cilin kemi filluar bashkë, më shumë dërgohej në terren pasi që ishte mashkull dhe për shkak të solidaritetit mashkullor me redaktorët. Unë duhej të japë dyfishin e kontributit për të dëshmuar se jam gazetarë më e mirë se kolegu im”.

“Mbaj mend se në të kaluarën ka pasur edhe kësi lloj situatash. Për shembull, në konfliktin e vitit 2001 dërgoheshin meshkujt në terren me arsyetim se mund të ketë rrezik gjatë ushtrimit të detyrës”.

“Gazetarja femër trajtohet si më e brishtë, më e ndjeshme, dhe duhet bëhet fjalë për ngjarje si për shembull sulmi në Parlament, protesta në të cilat mund të ketë incidente apo ngjashëm, është praktikë që të dërgohen në terren gazetarët meshkuj”

Trajtimi joadekuat në aspekt të shpërndarjes së detyrave dhe përgjegjësi vërtetohet edhe me rezultatet e anketës me gazetarë dhe punonjës mediatik në Maqedoninë e Veriut. Një e treta e të anketuarve (31 përqind) e kanë vlerësuar negativisht barazinë gjinore gjatë shpërndarjes së detyrave dhe përgjegjësi, dhe po aq të anketuar (33 përqind), kanë përzgjedhur notën mesatare, 3.20. 8 përqind kanë dhënë notën 5. 15 përqind kanë dhënë notën 4.

Si e vlerësoni barazinë gjinore gjatë shpërndarjes së detyrave dhe përgjegjësi?¹⁷



Përmirësimi dhe avancimi në punë është një prej fushave në të cilat vlerësohet se është i theksuar i ashtuquajturit diskriminim “i fshehur”, respektivisht dukuria e efektit të “tavanit të qelqtë”.

Prandaj, të anketuarat ishin pyetur për mundësitë për edukim të mëtejme dhe avancim në profesion brenda organizatave të tyre, qasjen dhe kriteret e tyre me ndihmën e të cilëve janë rregulluar.

Prej përgjigjeve të dhëna mund të vihet në konkluzion se mundësitë e tilla më së shpeshti janë vënë në dispozicion për të gjithë të punësuarit, pavarësisht gjinisë. Por,

¹⁷ Hulumtim për të drejtat e gazetarëve dhe punonjësve mediatik në Maqedoninë e Veriut, e realizuar nga ana e Sindikatës së pavarur të gazetarëve dhe punonjësve mediatik dhe Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë në periudhën gusht – shtator 2021.

mungesa e kriterëve të përcaktuara në mënyrë të qartë dhe rregullave për avancim në karrierë, mund të jenë pengesë serioze për ndarjen e drejtë gjinore gjatë shfrytëzimit të këtyre mundësive, edhe pse të anketuarat nuk e shohin këtë gjë si fenomen të tillë.



“Ekzistojnë mundësi për edukim shtesë por nuk ka kriterë të defnuara në mënyrë të qartë dhe formalisht, femrat kanë mundësi të barabarta sikurse meshkujt për të avancuar në sferën mediatike. Problemi është se sidomos tek mediat private shumë gjëra varen prej mendimit personal dhe vendimit të pronarit dhe drejtorëve, ndërsa nuk ka kriterë të saktësuara për edukim shtesë”.

“Ekzistojnë mundësi, por edhe kufij deri ku mund të shkohet. Gratë në media fitojnë mundësi por ekzistojnë ende stereotipet, mënyra e jetës dhe shoqëria patriarkale i pengojnë në shfrytëzimin e mundësive”.

“Në vendim tim të punës ekziston mundësia për avancim deri në një nivel të caktuar. Për shumicën e të punësuarve kjo mundësi nuk ekziston (jo për shkak të diskriminimit gjinor). Nuk ka kriterë të defnuara në mënyrë të saktë lidhur me avancimin dhe regresin (si në shumicën e firmave). Mendoj se në median ku punoj mundësitë për avancim nuk varen nga gjinia”.

“Në vendin aktual të punës nuk kam mundësi për trajnime shtesë, pasi që jemi numër i vogël gazetarësh dhe jemi të kufizuar në pjesën e trajnimeve, konferencave e ngjashëm. Megjithatë, në vendet e tjera të punës kam pasur kësi mundësi që të marr pjesë në konferencat, trajnimet më të mëdha ndërkombëtare për gazetarë për vite me radhë, në mënyrë të vazhdueshme. Prandaj nuk mendoj se problemi fshihet në këtë pjesë”.


“Në mediat e Maqedonisë së Veriut rrallë herë kam dëgjuar për mundësi për edukim shtesë, si për meshkujt ashtu edhe për femrat. Nuk ka trajnime të domosdoshme, apo vlerësim vjetor për punën (appraisal). Avancimi i të gjithëve, përveç nëpërmjet meritës profesionale, bëhet me miqësitë personale. Madje vlerësoj se ka femra që e shfrytëzojnë gjininë e tyre për avancim”.

Prej qëndrimeve të dhëna mund të vihet në konkluzion se nuk ekzistojnë rregulla/kriterë të qarta për avancim në karrierë, apo “trase të karrierës” në media si organizata punëtore. Por, nuk ka as plane për mësim shtesë në aspekt profesional duke u bazuar në analizat e nevojës për zhvillim të aftësive dhe njohurive të të punësuarve. Kjo tregon se nuk ka strategji për resurse njerëzore që do lidhej me strategjinë biznesore të organizatës. Përpilimi dhe harmonizimi i strategjive të këtilla do të mund ta avanconin pozitën e femrave si të punësuarat në media, nëpërmjet krijimit dhe implementimit të mekanizmave, strategjive dhe politikave adekuate.

Të dhënat që kemi fituar përsëri janë identike me ato të hulumtimit në terren ku në pyetjen nëse në median në të cilën punojnë ekzistojnë procedura apo rregulla të brendshme për sigurimin dhe respektimin e barazisë gjinore, madje 40.3 përqind

kanë thënë se nuk e dinë, ndërsa 18.5 përqind kanë thënë se në mediat e tyre nuk ka procedura dhe rregullore të tilla.

Në median ku punoni, a ekzistojnë rregullore dhe procedura për sigurimin dhe respektimin e barazisë gjinore?¹⁸



Sipas të njëjtit hulumtim, vetëm 25.7 përqind e të anketuarve kanë ndjekur trajnim për barazi gjinore.

4

ANALIZË E STRUKTURËS GJINORE NË MEDIA DHE ARSYET PËR NIVELIN E ULËT TË PËRFAQËSIMIT TË FEMRAVE NË POZITA MENAXHERIALE

Duke nisur nga viti 2010, Agjencia për shërbime audio dhe audio-vizuale me vetiniciativë në nivel vjetor siguron të dhëna për strukturën gjinore të të punësuarve në televizione dhe radio,¹⁹ ndërsa në regjistrat online të radiove dhe televizioneve rregullisht publikonin të dhëna për strukturën e pronësisë tek radiodifuzerët që përfshijnë edhe informacione për përfaqësimin e grave dhe burrave në pronësi.

¹⁸ Hulumtim për të drejtat e gazetarëve dhe punonjësve mediatik në Maqedoninë e Veriut nga ana e Sindikatës së Pavarur të Gazetarëve dhe Punonjësve Mediatik (SPGM) dhe Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM) në periudhën gusht – shtator 2021.

¹⁹ Analizat janë në dispozicion në <http://bit.ly/2FHHibz>

Sipas analizës së Strukturës së të punësuarve në vitin 2020, më 31.12.2020 në industrinë mediatike kanë qenë të punësuar gjithsej 2587²⁰ persona, prej të cilëve 61 përqind kanë qenë meshkuj, ndërsa 39 përqind femra. Prej të dhënave të theksuara, duket qartë dallimi në mes numrit të burrave dhe grave në poste udhëheqëse (drejtues/drejtorë), ku burrat janë të përfaqësuar me 78 përqind, ndërsa femrat me 22 përqind. Ndërkohë kur bëhet fjalë për gazetaret femra gjendja është më ndryshe. Janë evidentuar më shumë gazetarë (59 përqind) nga gazetarët meshkuj (41 përqind). Numri i redaktorëve dhe redaktoreve është thujse i barabartë, ndërsa tek kuadri teknik dominues janë meshkujt.²¹

Të dhënat e deritanishme për strukturën gjinore tek pronësia por edhe tek të punësuarit në nivelet që kanë fuqi për vendime (në pozitat drejtuese/të drejtorëve dhe redaktorëve) tek të gjithë televizionet dhe radiot, dëshmojnë për ekzistimin një përfaqësimi më të ulët të femrave në këto pozicione. Kjo megjithatë është tregues për ekzistencën e të ashtuquajturit “tavan i qelqtë” në këtë sferë, tregues për ekzistencën e barrierave joformale në rrugën për avancim profesional të femrave, një kufi i padukshëm mbi të cilin është tejet e vështirë që femrat të ngrihen në nivelet më të larta.²²


Megjithatë, pozicionimi momental i femrave në poste redaktuese dhe menaxheriale në media është vlerësuar negativisht nga vetëm 28 përqind e të anketuarve (notat më të ulëta, 1 dhe 2). Gjatë anketimit në kuadër të hulumtimit që e zbatuan Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punonjësve Mediatik (SPGM) dhe Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM), në vitin 2021, 41 përqind e të anketuarve kanë dhënë notë pozitive për ndarjen e barabartë gjinore (4.5), ndërsa 31 përqind kanë vendosur që të japin notën (3).

20 Në këtë analizë janë përfaqësuar vetëm numri dhe struktura e të punësuarve në industrinë audio dhe audio-vizuale në vitin 2020, ndërsa online mediat nuk janë përfshirë, sepse nuk ekzistojnë të dhëna zyrtare për numrin e të punësuarve dhe rrjedhimisht as për përfaqësimin gjinor.

21 AAgjencia për Shërbime Audio dhe Audio-vizuale. Struktura e të punësuarve 2020, qasur më 28 tetor 2021 <https://avmu.mk/wp-content/uploads/2021/09/Struktura-na-vrabotenite-vo-2020-godina.pdf>

22 Agjencia për Shërbime Audio dhe Audio-vizuale: Gjinia në televizione dhe radio: Kush i sjell vendimet dhe kush i zbaton ato? Qasur më 28 tetor 2021: <https://avmu.mk/wp-content/uploads/2020/12/Rodot-vo-TV-i-RA-Koj-gi-nosi-a-koj-gi-sproveduva-odlukite.pdf>

Si e vlerësoni vendosjen e femrave në pozicione redaktuese dhe menaxheriale?²³



Në intervistat e zhvilluara për qëllimet e këtij hulumtimi, gazetaret u pyetën për arsyet e përfaqësimit të ulët të grave në pozitat menaxheriale dhe drejtuese në media. Në pjesën më të madhe të deklaratave, si arsye kryesore përmendet perceptimi tradicional patriarkal i rolit të grave në shoqëri, stereotipet dhe vendosja e baraspeshës mes punës dhe obligimeve familjare, të cilat në pjesën më të madhe janë mbi supet e gruas.



“Kjo gjendje në media është reflektim i perceptimit të të gjithë shoqërisë për rolin e femrave. Mediat nuk dallojnë shumë nga sektoret e tjera ku shumicën e rasteve udhëheqin meshkujt”.

“Shumë vite të rregullimit politik konservativ, e patriarkal, implementim i ngadalshëm i kornizës ligjore në të cilën është përfshirë barazia gjinore, inkluziviteti dhe përfaqësimi i grave në sferën mediatike, sidomos në pozita të larta. Në mënyrë shtesë, shumë pak flitet për këto tema në opinion, nuk njihet diskriminimi i vazhdueshëm në vendin e punës, qasja seksiste në çdo sferë të jetës e kështu me radhë”.

“Mediat janë pasqyrë e shoqërisë. Prandaj duke marrë parasysh se në pozitat udhëheqëse në media ende dominojnë meshkujt, është e dukshme se deri ku jemi me vetëdijen si shoqëri e Maqedonisë në përgjithësi”.

“Ende ka stigmatizim të femrës në shoqërinë tonë. Në televizionet të cilat kam punuar deri tani, numri i burrave redaktorë është gjithnjë më i madh se i redaktoreve femra. Femra gjithmonë e kanë patur më të vështirë për të avancuar në karrierë për shkak të stigmatizimeve të caktuara shoqërore”.

23 Hulumtim për të drejtat e gazetarëve dhe punonjësve mediatik në Republikën e Maqedonisë së Veriut i zhvilluar nga Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punonjësve Mediatik (SPGPM) dhe Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM) në periudhën gusht – shtator 2021.

Në raste të caktuara fajin e shohin edhe tek vetë femrat të cilat nuk e shohin veten në pozita menaxheriale nga frika e prishjes së baraspeshës mes jetës private dhe asaj profesionale që lidhet me këtë profesion. Të njëjtën e vërteton edhe përqindja e lartë (93 përqind) e të anketuarave në: “Studimin për femrat në Maqedoninë e Veriut”, që e vlerësojnë ndarjen tradicionale/patriarkale gjinore të roleve në shoqërinë e Maqedonisë si të drejtë dhe pranojnë.²⁴

“Më së shpeshti gratë nuk kanë vetëbesim për kryerjen e detyrave në funksione menaxheriale dhe prandaj nuk i kanë si qëllim këto pozicione. Duke e ditur se prej tyre pritet që të balancojnë jetën private dhe karrierën, gjithnjë e më shumë femrat po vendosin që të mbeten në zonën e komfortit pasi që kështu vlerësojnë se në këtë mënyrë do të kenë më shumë kohë për të dyja – familjen dhe punën”.

Përfaqësimin jo të barabartë gjinor të grave në pozitat e larta në media, të anketuarit e lidhin në përgjithësi edhe me gjendjet e përgjithshme në sektorin e biznesit në shtet, ku meshkujt janë ata që dominojnë gjatë ndërmarrjes së rreziqeve, investimit të financave, shfrytëzimit të mundësive për nisjen e biznesit personal. Edhe sipas të dhënave të Entit Shtetëror të Statistikës, numri më i madh i sipërmarrësve janë meshkuj. Dhe kjo situatë përshkruhet edhe tek mediat. Ky fenomen daton prej periudhës së formimit të mediave private në Maqedoninë e Veriut kur meshkujt dominonin si themelues, drejtues, pronarë, për shkak të fuqisë financiare dhe statusit shoqëror dhe kjo vazhdon dhe përsëritet prej pavarësisht të shtetit e deri në ditët e sotme.

“Shumica e mediave, sidomos televizionet, gazetatat dhe radiot, janë formuar para më shumë dekadash dhe themeluesit e tyre kanë qenë meshkuj të cilët vetë kanë qenë drejtorë, dhe kanë emëruar drejtorë (meshkuj, njerëz të besueshëm) dhe kjo traditë është ruajtur dhe po vazhdon. Mediat më të reja janë portalet në të cilat themeluesit janë edhe drejtorë dhe sipas informacioneve të mija, shumica janë meshkuj. Ky është rezultat i shpërndarjes së fuqisë në të gjithë shoqërinë, jo vetëm në sferën mediatike, e sidomos kur bëhet fjalë për menaxhim me mjete financiare – gratë mund të jenë profesioniste të larta, por me paratë menaxhojnë meshkujt”.

“Mediat në Maqedoni kryesisht hapen për biznes, ndërsa duke marrë parasysh se gratë janë në numër më të vogël si pronare në biznese të mëdha, ata në numër më të vogël edhe si pronare/drejtoresha në media. Statistikisht më pak femra marrin rrezik në biznes (ndërsa mediat janë biznes me rrezik)”.

Një fakt inkurajues është që gazetaret që janë intervistuar janë të gatshme të pranojnë pozitë udhëheqëse. Të anketuarat me më shumë përvojë në këtë profesion, pozicionin e redaktore, pronares apo drejtores do ta pranonin menjëherë, ndërsa të anketuarat që janë në fillim të karrierës kanë gatishmëri, por pasi që të fitojnë përvojën e duhur apo të plotësojnë disa parakushte për të marrë përgjegjësinë që sjellë ai pozicion.

²⁴ “Studim për femrat në Republikën e Maqedonisë së Veriut” 2020/2021”.

KONKLUZA

Pa dyshim, industria mediatike e cila duhet të jetë një prej udhëheqësve në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe barazisë, ka para vetes sfida të rëndësishme gjinore.

Edhe pse në mesin e të anketuarave ekziston një perceptim i përgjithshëm se dallimi në paga mes gazetarëve dhe gazetareve femra ekziston, megjithatë ka hapësirë për dëshmi të mëtejme të këtij pohimi duke marrë parasysh se një përqindje e madhe e të anketuarve nuk kanë informacione për pagat e kolegëve të tyre, gjë që është një kufizim për hulumtimin.

Problemet kryesore me të cilat ballafaqohen janë pagat e ulëta, mungesa e kritereve të qarta për zhvillim profesional dhe të karrierës në media si organizata mediatike, më tej pabarazia gjinore në aspekt të emërimit për detyra specifike (atraktive), që në mënyrë direkte ndikojnë mbi imazhin profesional në opinion, ndërsa në mënyrë indirekte edhe në ardhmërinë profesionale të grave gazetare, sidomos duke marrë parasysh natyrën specifike të punës dhe ekspozimin ndaj opinionit të gjerë.

Ngjashëm sikurse në hulumtimet e tjera që lidhen me gratë dhe pozicionin e tyre botën biznesore²⁵, fuqia ekzekutive sikurse tek bizneset, edhe tek mediat është e koncentruar më shpesh tek meshkujt (si themelues, drejtues, pronarë, dhe më tej redaktorë).

Edhe pse ekziston tendencë që diskriminimi gjinor të njëjtësohet me të ardhurat e njëjta mes burrave dhe grave, vërtetohet prania e barrierave të padukshme që i pengojnë gratë në industrinë mediatike që të mësojnë më shumë dhe të avancojnë drejt pozitave menaxheriale. Më së shpeshti ky problem lidhet me rolet patriarkale gjinore të mbjella thellë në shoqëri (të pranuar edhe nga vetë gratë) por edhe me mungesën e rregullave të qarta, procedurave, akteve të brendshme në vetë organizatat, të cilat do të hapin rrugën dhe do të japin drejtimin e duhur për sigurimin e barazisë gjinore. Është e dukshme se për tejkalimin e këtyre barrierave duhet që të ndiqen shembujt e shteteve të zhvilluara për ta përshtatur profesionin që të jetë atraktiv për përfaqësuesit e të dy gjinive.

25 Topuzovska Llatković, Marija: Pozita dhe fuqia e femrave si anëtare të bordeve udhëheqëse në shoqërinë biznesore në Maqedoni, 2019.

REKOMANDIME

Hulumtimi vë në dukje një sërë sfidash me të cilat duhet të ballafaqohen të gjithë aktorët e shoqërisë sonë, me qëllim që të përmirësohet gjendja individuale dhe organizative e mediave, duke avancuar barazinë gjinore: prej bartësve të vendimeve dhe kreatorëve të politikave, deri te pronarët e mediave, organizatat sindikale si dhe të gjithë qytetarët, femra e meshkuj.

Industria mediatike para së gjithash duhet të punojë për largimin e “tavanit të qelqtë” dhe të pranojë më shumë femra në pozicione vendimmarrëse. Kjo mund të arrihet me:

- Themelimin e njësive organizative për zhvillim dhe menaxhim me resurse njerëzore në media (në pajtueshmëri me numrin e të punësuarve), gjë që do të rezultojë me strategji për burime njerëzore si pjesë e përgjithshme e strategjisë biznesore.;
- Procedura dhe rregullore të qarta për sigurimin e barazisë gjinore;
- Nënshkrimin e marrëveshjeve kolektive me organizatat kompetente sindikaliste që do të përmbajnë norma për barazi gjinore për të gjithë punonjësit mediatik, dhe do të rregullojë formalisht kompensimet, benefitet, si dhe mundësitë për zhvillim profesional dhe të karrierës me qasje të ndjeshme gjinore.

Rekomandohet që Enti Shtetëror për Statistikë ta ndajë profesionin e gazetarit/gazetares si një veprimtari të mëvetësishme, në mënyrë që të mundësojë pasqyrim më të mirë për strukturën gjinore dhe lartësinë e pagave.

Organizatat sindikaliste dhe sektori civil po ashtu mund të ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme për zgjidhjen e problemeve nëpërmjet organizimit më të shpeshtë të trajnimeve të rregullta për barazi gjinore për të gjithë punonjësit imediati.

Ata mund të shfrytëzojnë ekspertizën, dijen dhe të dhënat e tyre, për të përgatitur doracak për mediat, që do të ofrojë instrumente dhe praktika të dëshmuara që do të sillnin ndryshime pozitive.

Të gjithë palët e prekura duhet të pajtohen për formimin e indikatorëve gjinor për organizatat mediatike, me ndihmën e të cilëve do të matet progresi në implementimin e barazisë gjinore tek organizatat mediatike (dallimi në paga, mundësitë për avancim, leja e paguar e lindjes, përfaqësimi në përqindje i femrave dhe meshkujve në të gjithë sektoret e punës mediatike, e kështu me radhë)

Implementimi i praktikës për dorëzim të raporteve vjetore nga ana e të gjitha mediave lidhur me përfaqësimin e femrave në pjesën programore, strukturën gjinore të të punësuarve dhe lartësinë e të ardhurave mujore, do të rezultojë me punë transparente në drejtim të përmirësimit të barazisë gjinore në organizatat mediatike.

BIBLIOGRAFIA

- Topuzovska Llatkoviq, M. Borota Popovska, M. Starova, N. Çupeska, A. Gjorgjev D (2021): “Studim për gratë në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2020/2021”, Fondacioni “Fridrih Erbert”- zyra në Shkup.
- Topuzovska Llatkoviq, M. (2019); “Pozicioni dhe fuqia e grave si anëtare të bordeve drejtuese në shoqërinë biznesore të Maqedonisë në pjesëmarrje politike të grave në Maqedoninë e Veriut”, studim dhe punime shkencore-hulumtuese, Fondacioni për Demokraci i Vestminister, Maqedonia e Veriut.
- Ministria e Punës dhe Politikë Sociale: *Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi*
- Ministria e Punës dhe Politikës Sociale: *Ligji për Parandalim dhe Mbrojtje nga Dhuna mbi Gratë dhe Dhuna në Familje*, <https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/2021/1a28a922f364401e94935d4d694b9d75.pdf>
- Ministria e Punës dhe Politikë Sociale: *Ligji për Mundësi të Barabarta*, https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/zakoni/2017/precisten%20tekst%202015%20na%20ZEM_nov.pdf
- Probleme prioritare me respektimin e të drejtave të njeriut në Maqedoninë e Veriut, 2020. <https://balkon3.com/mk/wp-content/uploads/2021/01/PRIORITETNI-PROBLEMI-SO-POCHITUVANJETO-NA-CHOVEKOVITE-PRAVA-VO-RSM.pdf>
- SPGM : Gazetarët dhe punonjësit mediatik frikësohen nga virusi, por edhe nga humbja e punës. Shkup, 2020 <https://ssnm.org.mk/komentari/новинарите-и-медиумските-работници-с>
- SPGM: Gazetarët dhe punonjësit mediatik me paga shumë nën mesataren. Shkup, 2020 <https://ssnm.org.mk/komentari/новинарите-и-медиумските-работници-с-2>
- Si të zvogëlohet dallimi gjinor në paga në Maqedoninë e Veriut? Shkup, 2020, <http://coalition.org.mk/wp-content/uploads/2020/09/Dokument-za-javni-politiki-Ednakvi-plati-MKD.pdf>
- ASHMAA: Analizë e strukturës gjinore në pagat në radiodifuzion për vitin 2020, <https://avmu.mk/wp-content/uploads/2020/11/Rod-i-plati-vo-radiodifuzija-MK-web-1.pdf>
- SHGM/SPGM: Hulumtim për të drejtat e gazetarëve dhe punonjësve mediatik në Maqedoninë e Veriut e realizuar nga Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe

Punonjësve Mediatik (SPGM) dhe Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM)
në periudhën gusht – shtator 2021

Perceptimet për barazinë gjinore: gratë në ekonominë e Maqedonisë, studim
kombëtar – Shkup, Shoqata e Qytetarëve Reaktor, viti 2011

Ueb faqe



<https://www.merriam-webster.com/>

https://ec.europa.eu/info/sites/default/files/aid_development_cooperation_fundamental_rights/equalpayday_factsheet.pdf

POLICY PAPER

**KEY SYSTEM GAPS AND POSSIBLE SOLUTIONS
TO BRIDGE THE WAGE GAP AND POTENTIAL
HIERARCHICAL PROBLEMS IN MEDIA BASED ON
GENDER DISCRIMINATION**

Author: Nita Starova

Skopje

January 2022



B | T | D The Balkan Trust
for Democracy

A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND



Title: Key system gaps and possible solutions to bridge the wage gap and potential hierarchical problems in media based on gender discrimination – policy paper

Author: Nita Starova

Publisher: Association of Journalists of Macedonia

Project: Safer Media Workers for Quality Journalism in North Macedonia

English translation: Kristina Naceva

Print: Grafotrade doo Skopje

Circulation: 150

This publication has been produced with a financial support from the Balkan Trust for Democracy, a project of the German Marshall Fund of the United States and the Royal Norwegian Embassy in Belgrade. Opinions expressed in this publication do not necessarily represent those of the Royal Norwegian Embassy in Belgrade, the Balkan Trust for Democracy, the German Marshall Fund of the United States, or its partners.



CONTENT

- Introduction..... 52
- 1. Legal framework for gender equality in the country..... 53
- 2. Analysis of the economic situation of women in the media and the gender pay gap as a form of gender discrimination..... 55
- 3. The effect of “glass ceiling” or invisible barriers to progress of women in the profession..... 58
- 4. Analysis of the gender structure in the media and the reasons for the low presence of women in management positions in the media..... 62
- Conclusions..... 66
- Recommendations..... 67
- Bibliography..... 68

INTRODUCTION

